



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 40 prot.

Kamëz, më 28.5.2025

V E N D I M
Nr. 35. Datë 28/5 2025
MBI

“SHPREHJEN E PËLQIMIT NË PARIM MBI KËRKESËN NR. 2945/7 PROT., DATË 08.05.2025 TË MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 28.05.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.30 Datë 28.05.2025 në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, nenit 54 pika e/1 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; VKM-së nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë”; VKM-së nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Shkresës nr. 2945/7 prot., datë 08.05.2025, me lëndë: “Kërkojmë mendim në lidhje me disa pasuri”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e pëlqimit në parim mbi kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për vazhdimin e procedurave me organet kompetente për transferimin pranë kësaj ministrie të pasurisë, si më poshtë:
 - *Sipërfaqen prej 1200 ml, e llojit “kanal”, me nr. 268 pasurie, ZK 2066, e transferuar me VKM nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë”, sipas plan rievimit bashkëlidhur.*
2. Pasuria me Nr. 268, Zona Kadastrale 2066, të hiqet nga inventari i Bashkisë Kamëz dhe të transferohet pranë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për këtë objekt.
3. Pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për këtë objekt ngarkohet për zbatim Drejtoria e Kadastrës, Bordit të Kullimit, Pyjeve dhe Kullotave & Menaxhimit të Aseteve të Bashkisë Kamëz, dhe Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

